

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot më Datë 31.07.2023, lidhet kjo Kontratë Shit-Blerje Kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

Shitësit: Z. Hergys Rreli atësia Naim, amësia Nadire, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Ramazan Gaxherri 03900106; Nd. 3; H. 2; Ap. 23; Dajt; Linzë; 1040; Tiranë, lindur më 24/09/1981, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034461743 dhe nr. personal I10924042Q

Blerësit: Z. Bujar BENDO, atësia Pelivan, shtetas Shqipëtar, lindur në Lushnje më 02/07/1966 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal G60702148I.

(I cili në vijim të kësaj Kontrate do të referohen si "Blerësi")

Këtej e tutje “**Shitësi** dhe “**Blerësi**”, bashkërisht do të quhen “**Palët**” dhe individualisht secili prej tyre mund të quhet edhe “**Pala**”.

Meqënëse:

1. Shitësi Z. Hergys Rreli, është zotërues i një kuote të vetme të shoqërisë me vlerën 4,000.000(katër milion)lekë ose për 40% ne shoqerën “Interinvest Albanian Group” sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NIPT M22414027J, Investitor dhe investime në fushën e ndërtimit.Të tregtojë, ndërmjetësojne rolin e agjentit real estate për transaksione të pasurive të patundshme të gjitha llojeve brenda dhe jashtë kufijve shtetëror shqiptar. Te jap me qera, ndërmjetësoj për dhënie me qira, në huapërdorje dhe çdo lloj forme tjetër administrimi të pasurive të paluajtshme. Konsulenca të përgjithshme dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme
- Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota, me një vlerë prej 10.000.000 (dhjetë milion) lekë.
 - Përmes kësaj kontrate, Shitësi shpreh vullnetin në formën e parashikuar nga ligji, për të transferuar nëpërmjet shitjes 40% (dyzete perqinde) të kuotave në favor të Z.Bujar Bendo

- Të sipërpërmendurit, bazuar në Nenin 73/1 b të Ligjit Nr.9901 Dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe Nenin 705 dhe vijues të Kodi Civil, ranë dakort për kushtet e kësaj Kontrate Shitje Kuotash, si vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës dhe vlera

1.1 Shitësi Z. Hergys Rreli zotërues i një 1(një) kuote përfaqësn 40% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Interinvest Albanian Group" sh.p.k dhe pranon të transferojë kuoten prej 40% (dyzete perqinde) nëpërmjet shitjes me përfitues z.Bujar Bendo kundrejt vleres nominale 4.000.000 (kater milionë) lek.

1.2 Si pasojë e shitjes së mësipërme, Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë "Interinvest Albanian Group" sh.p.k do të ndahet në 2 (dy) kuota, përkatësisht

- Z. Bujar Bendo, ortak i nje kuote me 80 % ose ne vleren 8.000.000 leke,të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote.
- Z.Nelsi Gega, ortak i nje kuote me 20 % ose ne vleren 2.000.000 leke të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote.

Neni 2

Mënyra e pagesës

Pala blerësi do të kaloj vleren përkatëse në numrin e llogarise të palës shitëse në kontratë.Nisur nga fakti qe shitesi nuk ka derdhur kontributin e deklaruar ne krijimin e shoqerise per zoterimin e kuotes, vlera e ketij kontributi per shumen 4.000.000(kater milion) leke do kaloj ne llogari te shoqerise, kjo ne marrveshje me paleve.

Pamvarsisht menyres se pageses,bleresi behet zoterues i kuotes menjehere me nenshkrimin e saj.

Neni 3

Detyrimet e Shitësit

1. Pala Shitëse nëpërmjet kësaj kontrate deklaron dhe garanton Blerësit:
 - a. Shoqëria është person juridik i regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe ushtron aktivitet tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe dispozitave të statuti;
 - b. Pala Shitëse garanton se kuota objekt i kësaj Kontrate është e lirë nga çdo peng, barrë siguruese, hipotekë, apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre;

c. Shoqëria nuk është në proces falimentimi ose likuidimi.

Neni 4

Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka detyrimin të depozitojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim për t'u reflektuar në ekstraktin e Shoqërisë, ndryshimet në rrethin e ortakëve.

Neni 5

Pasojat e Kontratës së Shitblerjes

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë "Interinvest Albanian Group" Sh.p.k ndahet në 2 (dy) kuota sipas përcaktimeve të nenit 1 pika 2.

Neni 6

Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

BLERËSI

SHITËS

Z. Bujar Bendo



Z. Hergys Rreli

